



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:042684

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05473001

C.nr.181/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike të paditëseve V.Z nga Prishtina dhe F.U - I nga Vushtrria, të cilat i përfaqëson av.B.M nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë- Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensim të shujtave gjatë ditëve të pranisë në punë dhe kompensim të shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seance, me datën 19.03.2024, e mori dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M
(pa shqyrtim gjyqësor)

I.APROVOHET e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëseve V.Z nga Prishtina dhe F.U - I nga Vushtrria, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar, ushqimit (shujtave) gjatë ditëve të punës dhe kompensim e shpenzimeve të udhëtimit, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë, si e bazuar, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë, që:

- a) Paditëses V.Z, në emër të kompensimit të ushqimit (shujtave) për ditët e pranisë në punë gjatë periudhës kohore prej datës 16.10.2019 e gjerë me datën 31.10.2022 (pra për 511 ditë të pranisë në punë) të i'a kompensoj shumën prej 1022 euro si dhe në emër kompensimit të shpenzimeve për udhëtim (në shkallën prej 70 % të lartësisë se biletës) për periudhën kohore prej datës 05.03.2018 e gjerë me datën 31.10.2022, (për 610 ditë udhëtimi në punë) shumën prej 854 euro, si dhe
- b) Paditëses F.U - I, në emër të kompensimit të ushqimisë (shujtave) për ditët e pranisë në punë gjatë periudhës kohore prej datës 01.02.2021 e gjerë me datën 31.10.2022, (pra për 323 ditë të pranisë në punë) të i'a kompensoj shumën prej 646 euro si dhe në emër kompensimit të shpenzimeve për udhëtim (në shkallën prej 70 % të lartësisë se biletës) për periudhën kohore prej datës 01.02.2021 e gjerë me datën 31.10.2022 (për 323 ditë udhëtimi në punë) shumën prej 226,10 euro, me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë me datën 05.03.2021 e gjerë në pagesën definitive të detyrimit të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I.Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore është vendosur në marrëveshjen e arritur pranë ndërmjetësimit, në këtë gjykatë me nr.ND.1248/23 të datës 17.11.2023 lidhur me inflacion dhe kualifikim/licencim.

A r s y e t i m

Paditëset në këtë gjykatë kanë paraqit paditë, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shujtave (ushqimit) gjatë ditëve të punës dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë, bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe atë të vitit 2021 me arsyetimin se të njëjtat u takojnë ndërsa e paditura nuk ia ka kompenzuar.

Gjykata ia ka dërguar të paditues aktvendimin për përgjigje në padi, ndërsa e paditura ka paraqitë përgjigje në padi duke e kundërshtuar kërkesën e paditëses me arsyetimin se Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar me datën 18.04.2017 është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditëset kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga vërtetimet e lëshuara nga Sh.F.M.U J... në ..., Vushtrri, kontestuese nuk ishte prania e paditëseve në punë për ditët e pranisë në punë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjithashtu kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk e ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë dhe shpenzimeve për udhëtim.

Nuk është kontestues fakti që e paditura në shkollën ku paditësit janë të punësuar nuk ka kushte të ofrimit të ushqimit në punë përmes restaurantit, kuzhinës apo ndonjë forme tjetër.

Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditëses mirëpo edhe ky pretendim i të paditues është i pa bazuar pasi që paditëses kërkesat e tyre i kanë paraqitë brenda afatit ligjor me Ligjin e Punës.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilën dispozitë parashihet se: “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore të Kosovës, ku përcaktohet se: Pjesëmarrësit në raporte detyrimore janë të detyruar që t’i përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre, nenit 245, paragrafit 1, të po këtij ligji ku përcaktohet se: “kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 si dhe nenit 35 par 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore” dhe nenit 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 e në të cilat njëjtë është paraparë se: punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhet shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban, erdhi në përfundim se duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se Kontrata Kolektive e Kosovës, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual prodhon efekt juridik ndaj palëve ndërgjyqëse.

Nga vërtetimet e lëshuara nga Sh.F.M.U J... në ..., Vushtri të sipërcekura në emër të paditëseve vërtetohet se paditëset gjatë periudhës kohore për të cilën kanë kërkuar shpenzimet e shujtave dhe udhëtimit, kishin ditë pune si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga vërtetimet e lëshuar po nga Sh.F.M.U J... në ..., Vushtri vërtetohet se paditëset gjatë periudhës kohore për të cilën kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, kishin ditë udhëtimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga vërtetimi i lëshuar nga agjencia e udhëtimit Auto Taxi A..., Vushtri, vërtetohet se cmimi i biletës për një relacion Vushtri – D... dhe anasjelltas është 0,50 euro apo kthyesë 1 euro për paditësen F.U ndërsa për paditësen V.Z në relacionin fshati S... - Vushtri cmimi i biletës është 0,50 euro apo kthyesë 1 euro, sipas vërtetimit të lëshuar nga Agjencia e Udhëtimeve Shkendija Tours e datës 16.01.2023.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Sh.F.M.U J... në ..., Vushtri i datës 15.04.2024 vërtetohet se paditësja V.Z gjatë periudhës kohore nga data 16.10.2019 e gjerë me datën 31.10.2022 ka pasur 511 ditë të pranisë në punë.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Agjencia e Udhëtimeve Sh... e datës 16.01.2023 vërtetohet se paditësja brenda periudhës së lartcekur kohore respektivisht duke filluar nga data 01.02.2021-31.10.2022 ka udhëtuar nga Prishtina respektivisht fshati S..., e gjerë në Vushtri, dhe nga Vushtri për tek shkolla Sh.F.M.U J... në ..., Vushtri për 323 ditë me radhë, me biletë kthyesë nga 1 euro, pra $323 \times 1 \text{ euro} = 323 \text{ euro}$ si dhe nga relacioni Vushtri - Sh.F.M.U J... në ..., Vushtri me biletë kthyesë nga 1 euro, pra $323 \times 1 \text{ euro} = 323 \text{ euro}$ apo $323+323 = 646 \text{ euro}$ dhe nëse këtë shumë e pjesëtojmë me 70 % të shpenzimeve për rrugë për këtë periudhë kohore del të jetë lartësia prej 70 % e shpenzimeve të shkaktuara nga 646 euro është në lartësi prej 452,20 euro, ndërsa nga relacioni D... – Vushtri - Sh.F.M.U J... në fshatin ..., ka shpenzuar për udhëtim në të dy drejtimet shumë prej nga dy euro pra për periudhën kohore nga data 05.03.2018-01.02.2021 apo për $287 \text{ ditë} \times 2 \text{ euro} = 574 \text{ euro}$ dhe nëse këtë shumë e pjesëtojmë me 70 % të shpenzimeve për udhëtim për këtë periudhë kohore del të jetë shuma prej 401,80 euro. Dhe nëse i bashkojmë shumën $452,20 \text{ euro} + 401,80 \text{ euro}$ del të jetë shuma e aprovuar prej 854 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Sh.F.M.U J... në ..., Vushtri në emër të paditëses V.Z vërtetohet se paditësja e parë gjatë periudhës kohore që ka kërkuar shpenzimet e udhëtimit ka udhëtuar nga fshati ..., Vushtri ndërsa punon në Sh.F.M.U J... në ..., Vushtri kurse paditësja e dytë jeton në Vushtri ndërsa ka punuar në Sh.F.M.U J... në ..., Vushtri, sipas certifiktes së vendbanimit në emër të saj.

Duke pas parasysh se paditëset kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i bie se paditëset kanë shpenzuar edhe 30 % më tepër të shumës së kërkuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi por gjykata u'a aprovur shumën vetëm në lartësi prej 70 % të shpenzimeve të udhëtimit, me c'rast me një kalkulim të thjeshtë rezulton se paditëseve duhet tu kompensohet kjo kërkesë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, ndërsa paditëset kërkesat e tyre i kanë parashtruar pas precizimit për periudhën kohore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e që përfshin periudhën

kohore kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe pjesërisht edhe Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2021.

Gjithashtu vlen të theksohet se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 në nenin 45 të saj ka paraparë se Kontrata Kolektive do të zbatohet edhe për një vit tjetër nëse palët nuk tërhiqen nga e njëjta ndërsa gjykata nuk ka prova se nga e njëjta janë terheqë ndonjë palë kontraktuese.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditëses ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive në pajtim me nenin 378 të LPK-së e në pajtim me mendimin juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 01.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në faktin se për shpenzimet e procedurës kontestimore është vendosur në marrëveshjen e arritur pranë ndërmjetësimit, në këtë gjykatë me nr.ND.1248/23 të datës 17.11.2023 lidhur me inflacion dhe kualifikim/licencim.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.181/2021, datë: 19.03.2024

Gj y q t a r i
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.